

VENDIM
Nr. 874, datë 27.12.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR TË DHËNAT
PARËSORE DHE DYTËSORE, QË REGJISTROHEN NË REGJISTRIN
ELEKTRONIK TË PROFESIONISTËVE TË LICENCUAR PËR DHËNËSIT E
INFORMACIONIT, PËR NDËRVEPRIMIN ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE,
SI DHE PËR NIVELIN E AKSESIMIT PËR SUBJEKTET E INTERESUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14/1, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon përcaktimin e të dhënave që do të regjistrohen si të dhëna parësore dhe dytësore në Regjistrin Elektronik të Profesionistëve të Licencuar (në vijim Regjistri elektronik), që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e planifikimit, zhvillimit dhe disiplinimit të punimeve të ndërtimit pavarësisht nëse janë të regjistruar si persona fizikë ose juridik.

2. Struktura përgjegjëse për gjenerimin dhe përditësimin e të dhënave në Regjistrin elektronik është drejtoria përgjegjëse për licencat pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT ELEKTRONIK

3. Të dhënat parësore që përmban Regjistri elektronik janë:

- a) Numri unik i licencës profesionale;
- b) Selia ose vendi i ushtrimit të veprimtarisë së subjektit;
- c) Të dhënat e drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik;
- ç) Afati i vlefshmërisë;
- d) Kategoritë e licencës;

dh) Sanksionet apo masat disiplinore të dhëna me vendim nga Komisionet Disiplinore të licencimit.

4. Të dhënat dytësore që përmban Regjistri elektronik janë:

- a) Emërtimi i subjektit;
- b) Lloji i veprës penale për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë subjekti i licencuar;
- c) Kryerja e dënimit për veprën penale;
- ç) Shuarja, rehabilitimi, falja apo amnistia nga vepra penale;
- d) Gjokat dhe masat administrative të vendosura, duke përcaktuar dhe institucionin që i ka vendosur;

dh) Konfiskimet ndaj tyre në favor të shtetit, duke përcaktuar llojin e objektit të ndërtimit, adresën dhe kohën e ndërtimit;

e) Përfshirjen e zhvilluesit nga e drejta për të marrë leje zhvillimi ose ndërtimi nga autoritetet përgjegjëse për 5 vjet.

III. NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE DHE NIVELI I AKSESIMIT PËR SUBJEKTET E INTERESUARA

5. Regjistri elektronik ndërvepron me:

a) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) Portalin unik qeveritar “e-Albania”;

c) Portalin e-Lejet;

ç) Regjistrin Tregtar, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

d) Regjistrin e Gjendjes Penale, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

6. Dhënës të informacionit janë:

a) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;

b) Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit;

c) Njësitë e vetëqeverisjes vendore në rastet kur ndërtimi është kryer në territorin nën juridiksionin e tyre;

ç) Instituti i Ndërtimit;

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

7. Subjektet e interesuara janë zhvilluesit, zbatuesit, mbikëqyrësit, projektuesit, si dhe çdo subjekt tjetër i interesuar.

8. Niveli i aksesimit në Regjistrin elektronik është, si më poshtë vijon:

a) Veprimet në Regjistrin elektronik kryhen nga drejtoria përgjegjëse për licencat pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ka të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara në regjistrin;

b) Subjektet e interesuara sipas pikës 7 kanë akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në leximin e të dhënave që ndodhen në Regjistrin elektronik.

9. Çdo veprim në Regjistrin elektronik lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin apo përhapjen e të dhënave duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale.

10. Regjistri elektronik është publik dhe publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

11. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bashkëpunon dhe bashkërendon punën me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për ngritjen dhe hostimin e regjistrit.

12. Regjistri elektronik si bazë të dhënash shtetërore bëhet në formatin Web-based dhe hostohet në serverat e AKSH-it.

13. AKSHI, në cilësinë e autoritetit rregullator koordinues të bazave të të dhënave shtetërore, është përgjegjës për krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative, që sigurojnë ndërveprimin e Regjistrit elektronik me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

14. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Instituti i Ndërtimit, si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama